

20130230717

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PËR SIGURI DHE
SHENDET GJATE PUNES

Neni 1

Në Ligjin për siguri dhe shendet gjate punes ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 92/2007 dhe 136/11), pas nenit 18 shtohen kater nene të rinj 18-a, 18-b, 18-v dhe 18-g, si vijojne:

"Neni 18-a

(1) Persosje profesionale të personave profesionale gjate punes kryhet nepermjet pjesemarrjes në trajnime për persosje profesionale.

(2) Persosjen profesionale e organizojne dhe zbatojne institucionet mesimore shkencore, organet shtetore, personat juridike nga sfera e sigurise dhe shendetit gjate punes (në tekstin e metejme: organizatori), të cilet i plotesojne keto kushte:

- të kene së paku dy persona që kane realizuar dhe mbajtur së paku tri trajnime nga sfera e sigurise gjate punes në nivel nacional dhe nderkombetar,
- të kene së paku tre vjet pervoje pune në organizimin e konferencave nationale dhe nderkombetare nga sfera e sigurise gjate punes,
- të kene miratuar program vjetor për realizimin e trajnimeve nga sfera e sigurise gjate punes, që vecanerisht i permban format e persosjes profesionale, kriteret për percaktimin e pikave sipas llojit të trajnimeve dhe kohezgjatjen e trajnimeve dhe
- të kene të siguruar hapesire për mbajtjen e trajnimeve.

Neni 18-b

(1) Organizatori i trajnimeve parashtron kerkese i te ministri kompetent për ceshtje nga sfera e punes për marrje të lejes zbatim të trajnimeve për persosje profesionale të personave profesionale për siguri gjate punes.

(2) Pas parashtrimit të kerkeses nga paragrafi (1) të ketij neni, ministri kompetent për ceshtje nga sfera e punes në afat prej 30 ditesh miraton aktvendim për pranimin ose refuzimin e kerkeses.

(3) Ministri kompetent për ceshtje nga sfera e punes me propozim të Inspektoratit Shtetor të Punes, miraton aktvendim për heqjen e lejes për zbatimin e trajnimeve për persosje profesionale personave profesionale për siguri gjate punes, nese organizatori nuk i zbaton trajnimet në pajtim me programin për zbatimin e trajnimeve nga sfera e sigurise gjate punes nga neni 18-a paragrafi (2) alineja 3 të ketij ligji ose nese tanime nuk i ploteson kushtet e parapara në nenin 18-a paragrafi (2) alinete 1 dhe 4 të ketij ligji.

(4) Kunder aktvendimit të ministrit nga paragrafet (2) dhe (3) të ketij neni parashtruesi i kerkeses, perkatesisht organizatori ka të drejte ankese në afat prej tete ditesh te Komisioni Shtetor për Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedure të Marredhenies së Punes në Shkalle të Dyte.

Neni 18-v

(1) Për sigurimin e persosjeve të vazhdueshme profesionale në periudhe prej pese vitesh personat profesionale për siguri gjate punes jane të obliguar që të fitojne 100 pike permes pjesemarrjes në trajnime për persosje profesionale.

(2) Pjesemarrja në trajnime për persosje profesionale eshte aktive, nese pjesemarresi-person profesional prezanton punim personal në cilesine e ligjruetit të trajnimit dhe pasive nese pjesemarresi-person profesional e percjell trajnimin në cilesine e degjuesit.

(3) Organizatori leshon vertetim për pike të fituara për pjesëmarrje në trajnime për persosje profesionale.

(4) Menyren e marrjes së pikeve në pjesëmarrjen aktive dhe pasive nga paragrafi (2) të ketij neni dhe formen e formularit të vertetimit nga paragrafi (3) të ketij neni, i percakton ministri kompetent për ceshtje nga sfera e punes.

Neni 18-g

(1) Organizatori eshte i obliguar që në afat prej 15 ditesh pas mbajtjes së trajnimit me shkrim ta informoje Inspektoratin Shteteror të Punes për llojin, kohezgjatjen dhe numrin e pjesëmarrësve në trajnimit e zbatuar.

(2) Personi profesional eshte i obliguar që më së voni deri më 31 mars të vitit rrjedhes ta njoftoje Inspektoratin Shteteror të Punes për numrin e pergjithshem të pikave që i ka fituar nga pjesëmarrja në trajnime për persosje profesionale në vitin paraprak.

(3) Për njoftimin nga paragrafi (2) të ketij neni Inspektorati Shteteror i Punes mban evidence, e cila i permban emrin dhe mbiemrin e personit profesional, numrin e vertetimit dhe piket e fituara."

Neni 2

Në nenin 45 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Ministri kompetent për ceshtje nga sfera e punes e percakton lartesine e shpenzimeve për kryerjen e puneve profesionale në baze të llojit, menyres, vellimit dhe vendit të kryerjes së puneve profesionale."

Paragrafet (2), (3), (4), (5), (6), (7), (8), (9), (10), (11), (12), (13), (14), (15), (16), (17), (18), (19), (20), (21), (22), (23), (24) dhe (25) behen paragrafe (3), (4), (5), (6), (7), (8), (9), (10), (11), (12), (13), (14), (15), (16), (17), (18), (19), (20), (21), (22), (23), (24), (25) dhe (26).

Neni 3

Në nenin 48-b pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Inspektorati Shteteror i Punes perpilon raport gjashtemujor për shkeljet e konstatuara të rregullave nga sfera e sigurise dhe shendetit gjate punes, nga personat profesionale të autorizuar për kryerjen e puneve profesionale për siguri gjate punes dhe i njejt shpallet në ueb faqen e Inspektoratit Shteteror të Punes".

Neni 4

Në nenin 56 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Gjobe në shume prej 700 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet punedhenesit - personit fizik për kundervajtje nga paragrafi (1) i ketij neni."

Neni 5

Në nenin 57 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Gjobe në shume prej 1 500 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet punedhenesit - personit fizik për kundervajtje nga paragrafi (1) i ketij neni."

Neni 6

Në nenin 58 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Gjobe në shume prej 4 000 deri më 5 000 euro në kundervlere me denare do t'i shqiptohet punedhenesit - personit fizik për kundervajtje nga paragrafi (1) të ketij neni ".

Paragrafi (3) që behet paragraf (4) ndryshohet si vijon:

"(4) Organ kompetent për mbajtjen e procedures kundervajtese dhe shqiptimin e sanksioneve kundervajtese nga paragrafet (1), (2) dhe (3) të ketij neni eshte gjykata kompetente."

Neni 7

Aktet nenligjore të parapara me kete ligj do të miratohen në afat prej gjashte muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Neni 8

Dispozitat e nenit 1 të ketij ligji me të cilat shtohen dispozitat e nenit 18-v paragrafi (1) do të fillojne të zbatohen pas kalimit të një viti nga hyrja në fuqi e aktit nenligjor nga neni 1 i ketij ligji me të cilin shtohet neni 18-v paragrafi (4).

Neni 9

Autorizohet Komisionit Juridik Ligjvenes i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të percaktoje tekst të spastruar të Ligjit për siguri dhe shendet gjate punes.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".